



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.293/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi-kryesues, Skender Çoçaj dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Besnik Balaj, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Suharekës, nga rradhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), të paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Suharekë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.293/2025, datë 21.10.2025, e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Suharekës, Besnik Balaj nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV) të paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Suharekë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 21.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Suharekës, Besnik Balaj, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), me të cilën pretendon se ka dyshime në lidhje me procesin e numërimit dhe procesimit të votave të kandidatëve për kuvend komunal në QKN në palestrën sportive në Suharekë “13 Qershori”. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se shqetësimet e mija ngritën mbi bazën e të dhënave të cilat kanë ndryshuar në sistem gjatë gjithë kohës së numërimit dhe procesimit të tyre në sistem. Andaj, më anë të kësaj ankesë i drejtohem PZAP-it ti kërkoj rinumërim të votave të subjektit politik LVV në Suharekë dhe të eliminohen këto mundësi të manipulimit të votës se qytetarëve.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së

rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallën nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Suharekës, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si ne vijim: *“Me aktivitetet e punës në Qendrën Komunale e Numërimit (QKN) në Suharekë kemi filluar me datën 13.10.2025 në ora 16:00”* dhe në QKN kanë qenë gjithsej 10 tavolina punë të cilat janë përberë nga anëtarë të subjekteve politike LVV, LDK, PDK dhe AAK. Për secilën tavolinë kanë qenë të pranishëm edhe vëzhgues nga subjekte të ndryshme politike dhe mediat e akredituara të cilët e kanë monitoruar vazhdimisht në procesin e numërimit. Procesi është mbikëqyrur përmes kamerave të sigurisë të vendosura në çdo tavolinë punë si dhe nga 5 kamera shtesë që e kanë mbuluar tërë hapësirën e Qendrës së Numërimit. Gjatë gjithë procesit të numërimit nuk është evidentuar asnjë vërejtje apo ankesë nga ana e vëzhguesve të pranishëm. *“Procesi i numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit është përmbyllur më datë 16.10.2025, në ora 15:45, ditën e enjte”*. Lidhur me pretendimet e palës ankuese për mospërputhje të rezultatit zgjedhor, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesave është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkangjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e mospërputhjes së rezultateve zgjedhore. Andaj, pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEKKZ në komunën e Suharekës, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 16.10.2025, në ora 15:45 ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 21.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, par.1 të LZP. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Gjithashtu, ju njoftojmë se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pasafatshme

Në këtë rast, PZAP nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, ankesës së ankuesit, përgjigjen në ankesë të KQZ-se konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 21.10.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në numërim të votave, ndërsa sipas përgjigje nga KQZ dhe Provave të Bashkangjitura procesi i numërimit në Qendër Komunale është përmbyllur me datë 16.10.2025 në ora 15:45, ditën e enjte.

Me dispozitën e nenit 105 paragrafi 1, në mënyrë decitive parashihet se *"Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar," të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo kuptohet se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.*

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që *"Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara",* ndërsa nën paragrafi 5.16. parashihet që *"Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR".*

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor."*

PZAP Konstaton se nga përgjigja e KQZ është vërtetuar se aktiviteti i QKN-së në Komunën e Suhareke, është përmbyllur më datë 16.10.2025, në ora 15:45, ditën e enjte, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Suharekës Besnik Balaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të parregullsive në numërim të votave, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuara me dispozitat e lartecekuar, andaj PZAP vendosi që ankesa e ankuesit të hedhen si e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 105 paragraf 1 i LZP-së, nenit 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.293/2025, datë 24.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.